

UNMIK/REG/2001/5
4 mars 2002

REGULLORE NR. 2002/5

**MBI NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut MBI EKZEKUTIVIN E
INSTITUCIONEVE TË PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin e dhënë atij me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) të Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, të datës 13 shtator 2001, Mbi Ekzekutivin e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Në harmoni me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9, të datës 15 maj 2001, Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Pas konsultimeve me partitë politike dhe koalicionet e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës,

Ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19, duke e reviduar Nenin 2.2 dhe Shtojcën VI dhe, duke shtuar Shtojcën XI si vijon:

Neni 1
Ndryshimet

1.1 Neni 2.2 i Rregullores nr. 2001/19 është si vijon:

2.2 Ministritë që bartin përgjegjësitë dhe kryejnë funksionet e parapara në shtojcat përkatëse të kësaj Rregulloreje janë:

- (a) Ministria për Ekonomi dhe Financa (Shtojca II);
- (b) Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë (Shtojca III);
- (c) Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (Shtojca IV);

- (d) Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve (Shtojca V);
- (e) Ministria e Shëndetësisë (Shtojca VI);
- (f) Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (Shtojca VII);
- (g) Ministria e Transportit dhe e Komunikacionit (Shtojca VIII);
- (h) Ministria e Shërbimeve Publike (Shtojca IX);
- (i) Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (Shtojca X);
dhe
- (j) Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (Shtojca XI).

- 1.2 Shtojca VI e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, do të jetë ashtu siç është prezentuar në materialin shtesë I të kësaj Rregulloreje.
- 1.3 Shtojca e re XI e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 do të jetë ashtu siç është prezentuar në materialin shtesë II të kësaj Rregulloreje.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 4 mars 2002.

Michael Steiner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca VI

Ministria e Shëndetësisë

Kjo ministri:

- (i) Krijon politikën dhe implementon ligjet e një sistemi jodiskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor;
- (ii) Koordinon aktivitetet në sektorin e shëndetësisë për të promovuar zhvillimin koherent të politikës për shëndetësi;
- (iii) Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
- (iv) Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- (v) Përcjell situatën e shëndetësisë dhe implementon masat adekuatë për të parandaluar dhe kontrolluar problemet në lëmin e shëndetësisë;
- (vi) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me kujdesin shëndetësor nën përgjegjësinë e kësaj ministrie;
- (vii) Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin;
- (viii) Merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet shëndetësore;
- (ix) Inkurajon zhvillimin e arsimit shëndetësor për ngritjen e njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë;
- (x) Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbikëqyr shërbimet e kontrollit të kualitetit të ushqimit dhe të lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Shtojca XI

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor

Kjo ministri:

- (i) Koordinon aktivitetet në lëmin e mbrojtjes së mjedisit për nxitjen e zhvillimit koherent të politikës për shëndetësi dhe mbrojtjen e mjedisit;
- (ii) Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime në lëmin e mbrojtjes së mjedisit duke i respektuar standardet relevante ndërkombëtare;
- (iii) Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet tjera sipas nevojës;
- (iv) Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës që ndërlidhet me mbrojtjen e mjedisit në përgjegjësinë e kësaj ministrie;
- (v) Përkrah pjesëmarrjen, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve të komunitetit që ndërlidhen me shëndetin dhe mbrojtjen e mjedisit;
- (vi) Krijon politikën, zbaton ligjet dhe mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin;
- (vii) Merr pjesë në zhvillimin dhe implementimin e fushatës për informim publik dhe të projekteve të tjera promovuese për të rritur vetëdijësimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet për mbrojtjen e mjedisit;
- (viii) Monitoron dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike meqë ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- (ix) Inkurajon zhvillimin e arsimit për mjedisin me qëllim të ngritjes së njohurive dhe kompetencave në lëmin e mbrojtjes së mjedisit;
- (x) Krijon politikën për menaxhimin e resurseve të ujit dhe mbikëqyr implementimin e tyre;
- (xi) Përkrah zhvillimin, implementimin dhe transferimin e teknologjive të pastra;
- (xii) Në bashkëpunim me ministrinë tjera përkatëse, identifikon fushat që duhet mbrojtur për të mirën e popullatës, krijon politikën dhe implementon masa për ruajtjen dhe administrimin e tyre;
- (xiii) Siguron inkorporimin e planit hapësinor mbarëkosovar në politikën dhe programet e Qeverisë dhe mbikëqyr implementimin e tyre nga autoritetet përkatëse.